# DËSHMI ARKIVI

**A-447600**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dita e 109-të e protestës/ Qytetarët rikthehen në shesh, paralajmërohet marshim drejt Parlamentit |
| ADRESA | `https://albeu.com/lajme/dita-e-109-te-e-protestes-qytetaret-rikthehen-ne-shesh-paralajmerohet-marshim-drejt-parlamentit/1013514/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 05:36:35 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 05:29:03 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `9e5e4867475cb63c502a11874919a7621cef73d90816a0f67d92a97b3b1ea4a3` |
| TEKSTI | `3d0c27282d95581e8131bcdf49df77ebc3b0329183dfbfeb25e2ff148205b622` |
| PAMJA | `1a885cdf5e68c28b2766f656fd42940eb5a6c0f34082f7724698460c1a1e5e16` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `047e5784a9c7bbc41070648b6d41013b69fd1b7374c73abd98169076f504e31b` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `6d9560e9dee7d667e4c0855efa59278dec1e8935faed252449ae9de5f9970896` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/047e5784a9c7bbc41070648b6d41013b69fd1b7374c73abd98169076f504e31b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Dita e 109-të e protestës/ Qytetarët rikthehen në shesh, paralajmërohet marshim drejt Parlamentit



Protesta kundër qeverisë së Edi Ramës, hyn sot në ditën e 109-të, me qytetarët dhe aktivistët që pritet të mblidhen sërish në Tiranë, për të vijuar atë që e kanë cilësuar si revoltë të pandërprerë.

Tubimi i sotëm vjen pas një dite të ngarkuar protestash në kryeqytet. Në ditën e 108-të, pjesëmarrësit u mblodhën fillimisht para Kryeministrisë dhe më pas marshuan nëpër rrugët e Tiranës, me thirrje kundër qeverisë dhe kërkesa për dorëheqjen e Ramës.

“Shqipëria po bën revolucion”, “Nuk shitet Shqipëria, shitet qeveria”, “Ju erdhi fundi” dhe “Arrestoni Ramën” ishin disa prej thirrjeve që shoqëruan marshimin.

Protestuesit iu drejtuan gjithashtu SPAK-ut, duke kërkuar vijimin e hetimeve dhe arrestimeve ndaj zyrtarëve të lartë.

Aktivisti Arben Kola përmendi kryeministrin Edi Rama dhe Belinda Ballukun, ndërsa deklaroi se presioni qytetar duhet të vazhdojë.

*“Veliaj në qeli dhe shqiptarët të lirë. Radhën e ka Rama me Belinda Ballukun. Ju ftoj çdo ditë në shesh të rrisim presionin popullor*”, deklaroi Kola.

Protesta e së martës nuk qëndroi vetëm para Kryeministrisë. Pas marshimit në kryeqytet, pjesëmarrësit u drejtuan te Blloku i Sigurisë në rrugën “Mine Peza”, ku kërkuan lirimin e protestuesve të ndaluar.

“Nuk jeni vetëm”, “Lironi shqipet” dhe “Gjithë Shqipëria është me ju”, ishin thirrjet e tyre para ambienteve ku mbahen të ndaluarit.

Ndërkohë, dita e 109-të pritet të shërbejë edhe si pararendëse e protestës së paralajmëruar për të enjten. Nga tubimi i një dite më parë u bë thirrje që qytetarët të mblidhen në orën 10:00 para Parlamentit, në kohën kur

të fundit/

Vendimi pritet në orën 10:00: Kosova, diaspora dhe Haga n…

Helikopteri përplaset pranë zonës tregtare në Los Angeles, tre viktima

Parashikimi i motit 16 Shtator 2026/ Kthjellime dhe vranësira, reshje…

Barcelona hap negociatat për rinovimin e Raphinhas, Deco…

Pse disa njerëz nuk e ndryshojnë fotografinë e profilit për vite me…

Horoskopi 16 Shtator 2026/ Njihuni me surprizat e yjeve për…

Dëmtimet më të zakonshme nga aksidentet me skuter…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Kuvendi do të zhvillojë punimet.

*"Do të jemi të gjithë të enjten në orën 10:00 te Parlamenti"*, ishte thirrja e bërë nga protestuesit, të cilët kanë paralajmëruar se aksioni nuk do të ndalet vetëm te tubimet e përditshme para Kryeministrisë.

Shtuar më 16.09.2026 07:29

Tags: dita 109 , protesta



Parashikimi i motit 16 Shtator 2026/ Kthjellime dhe vranësira, reshje shi…



Nga Kosova në Hagë, shqiptarët presin vendimin për krerët e UÇK-së nga…



Pagat e magjistratëve, Shehaj për Ramën: Është i dëshpëruar, duhet të…



34-vjeçarja akuzoi dajën e saj për rrëmbim dhe pë*dhunim, deputetja…



Bypassi i Elbasanit nis ndërtimin, Karakaçi: Do të lehtësojë trafikun



Bardhi: Akuzat ndaj Ballukut janë rënduar, SPAK po i lë kohë Ramë…




Kostoja e përballimit të mbrojtjes ligjore për të akuzuarit në Hagë nga…



Aksident i trefishtë në aksin Lezhë-Shkodër, tre të plagosur pranë kryqëzimi…

albeu © 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko… Kërko

**Kryesore**
- Erion Veliaj
- Free Esim
- Zgjedhjet 2025
- Belinda Balluku
- SPAK
- Kombëtarja

**Kategori**
- Lifestyle
- Showbiz
- Tech
- Shëndetësi
- Argetim
- Enciklopedi

**Linqet**
- Live tv shqiptare
- Moti në Shqipëri
- Travel
- Horoskopi
- Livescore
- News from Albania

**Tags**
- Edi Rama
- Albania News
- Ilir Meta
- Piranjat
- gazeta, tv, portale
- Sali Berisha

**Moti**
- Moti në Tiranë
- Moti në Prishtinë
- Moti në Shkup
- Moti në Durrës
- Moti në Prizren
- Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com |

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.